



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -035

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-224
PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-224
PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Neni 1

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, fjalët „apo kreut të Prokurorisë Speciale”, fshihen nga teksti i ligjit.

2. Neni 2 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.7 shtohet nënparagrafi i ri 1.8 me tekstin si në vijim:

1.8.Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve – Komisioni i themeluar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Neni 2

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 fshihet nga teksti i ligjit.

2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.27 shtohen nënparagrafët të ri 1.28, 1.29, 1.30, 1.31, 1.32, 1.33 me tekstin si në vijim:

1.28. nxjerrjen e rregullores për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për organizmin e provimit për kandidatët për prokuror;

1.29.nxjerrjen e rregullores për procedurën e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të shtetit dhe emërimit të kryeprokurorëve të prokurorive;

1.30.nxjerrjen e rregullores për organizimin e brendshëm të prokurorive;

1.31.shpalljen dhe organizimin e provimit për prokuror në bashkëpunim me institucionin që organizon trajnime në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.32 garantimin e një sistemi të hapur dhe të përgjegjshëm të administrimit të vendimeve të saj dhe të tërë sistemit prokurorial;

1.33 raportimin para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikator të matshëm çdo gjashtë (6) muaj.

Neni 3

Neni 5 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli), përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, me mandat pesë (5) vjeçar si vijon: “

1.1. dhjetë (10) anëtarë nga radhët e prokurorëve dhe atë:

1.1.1. Kryeprokurori i Shtetit;

1.1.2. shtatë (7) anëtarë prokurorë nga prokuroritë themelore, të përfaqësuara me nga një (1) anëtar, të zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;

1.1.3. një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;

1.1.4. një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria Speciale, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;

1.2. një (1) anëtar avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës;

1.3. një (1) anëtar, profesor universitar i drejtësisë;

1.4. një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile;

1.5 Anëtarët e Këshillit nga paragrafi 1.1 i këtij neni, përveq Kryeprokurorit të Shtetit, nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht detyrën e kryeprokurorit të cilësdo prokurori.

2. Tre (3) anëtarët jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas nenit 65 (10) të Kushtetutës, zgjidhen me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, bazuar në një listë

prej së paku tre (3) kandidatëve për secilën pozitë të propozuara nga organet përkatëse e që përfshin:

2.1. një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;

2.2. një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës;

2.3. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile. Përfaqësuesi i shoqërisë civile përzgjidhet me anë të konkursit publik të shpallur nga KPK, i cili duhet të ketë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë, njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut, përvojë pune në çështjet ligjore prej pesë (5) viteve, i paanshëm politikisht për të paktën në tre (3) vitet e fundit dhe i cili ka përkrahjen e së paku pesë (5) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë.

3. Anëtarët e Këshillit pasqyrojnë natyrën shumetnike dhe parimet e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës. Këshilli do të miratojë rregullore të veçantë për zbatimin e këtij paragrafi.

4. Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Këshillit, zgjedhën nga radha e anëtarëve prokurorë të Këshillit, me mandat tre (3) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Të zgjedhurit në këtë pozitë, nuk e zgjatë mandatin e anëtarit të Këshillit.

5. Kryesuesi i Këshillit pezullon pozitën e prokurorit të shtetit dhe ka të drejtën që t'i kthehet shërbimit si prokuror i prokurorisë në të cilën ka shërbyer para zgjedhjes kryesues i Këshillit.

6. Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë në kompensim. Këshilli do të miratojë skemën e kompensimit të anëtarëve të Këshillit, që nuk kalon njëzet e pesë përqind (25 %) e pagës bazë, përjashtuar kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin. Anëtari i që vjen nga Oda e Avokatëve, nuk mund të ushtojë detyrën e avokatit, derisa është anëtar i Këshillit. Paga e anëtarit nga Oda e Avokatëve, caktohet dhe paguhet nga Oda e Avokatëve.

7. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të Këshillit, i njëjti nuk mund të ngritet në detyrë në sistemin prokurorial.

Neni 4

Pas neni 5 të ligjit bazik shtohet neni i ri 5/A me tekstin si në vijim:

Neni 5/A

Kryesuesi dhe Zëvendëskryesuesi i Këshillit

1. Kryesuesi i Këshillit shërben si anëtar i Këshillit me kohë të plotë dhe ka këto autorizime:

1.1. kryeson të gjitha takimet e Këshillit;

- 1.2. miraton përgatitjen e rendit të ditës dhe pikave që do t'i dërgohen Këshillit;
 - 1.3. përfaqëson Këshillin para publikut, agjencive qeveritare dhe organeve të tjera publike vendore dhe ndërkombëtare;
 - 1.4. mbikëqyr dhe menaxhon punën e Këshillit dhe komisioneve të tij.
2. Kryetari i Këshillit së paku një herë në vit paraqet raporte publike vjetore për performacën, veprimet, kostot dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial;
 3. Organizon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve të përhershme sipas këtij ligji, duke i mundësuar Këshillit një proces transparent dhe të përgjegjshëm të propozimeve dhe emërimit të tyre.
 4. Zëvendëskryesuesi ushtron përgjegjësitë dhe detyrat e Kryesuesit, kur ai mungon. Zëvendëskryesuesi ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Këshillit në rast të mungesës apo paaftësisë së Kryesuesit.
 5. Gjatë mandatit të tyre, Kryesuesi dhe Zëvendëskryesuesi i Këshillit pranojnë kompensimin si në vijim:
 - 5.1. Kryesuesi i Këshillit pranon pagë si ajo e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor;
 - 5.2. Zëvendëskryesuesi i Këshillit pranon pagë si ajo e Zëvendëskryesuesit të Këshillit Gjyqësor.

Neni 5

Pas nenit 8 të ligjit bazik shtohet neni i ri 8/A me tekstin si në vijim:

Neni 8/A Komisionet e Këshillit

1. Këshilli ka komisionet e veta të përhershme si në vijim:
 - 1.1. Komisioni për Çështje Normative;
 - 1.2. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel;
 - 1.3. Komisioni për Administrimin e Prokurorive;
 - 1.4. Komisioni Disiplinor;
 - 1.5. Komisioni për vlerësim të performances së prokurorëve.
2. Këshilli mund të themelojë edhe komisione të tjera të përkohshme ose të përhershme, sipas nevojës.

Neni 6

Neni 8 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8 Pushimi dhe shkarkimi nga funksioni i anëtarit të Këshillit

1. Anëtarëve të Këshillit u pushon funksioni i anëtarit me:
 - 1.1. vdekje;
 - 1.2. humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkak të arsyeve mjekësore të vërtetuara;
 - 1.3. dështimin e vazhdueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit për më shumë se tre (3) muaj;
 - 1.4 pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi, nëse emërimi bazohet në një status të caktuar;
 - 1.5. skadimin e mandatit;
 - 1.6. dorëheqje duke informuar Këshillin me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.
2. Anëtarët e Këshillit shkarkohen nga funksioni me 2/3 dhe në pajtim me Rregulloren e Këshillit, ndërsa anëtarët të cilët zgjidhen nga Kuvendi, shkarkohen me propozim të Këshillit me shumicën e votave të të gjithë Deputetëve të Kuvendit, nëse:
 - 2.1.funksionin e anëtarit të Këshillit nuk e kryen në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin; dhe
 - 2.2.ushton funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, dhe
 - 2.3.është dënuar për vepër penale.
3. Nëse një vend në Këshill lirohet para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati. Personi, përveç Kryeprokurorit të Shtetit, i cili zgjedhet të plotësojë një vend të lirë në Këshill emërohet apo zgjedhet me një mandat të plotë pesë (5) vjeçar.

Neni 7

Neni 10 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 10
Përgjegjësia personale e anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit nuk mbajnë përgjegjësi penale për vendimet, mendimet dhe veprimet, brenda fushëveprimit të tyre si anëtar të Këshillit”.

Neni 8

Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 2 riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Kuorumi për takime të Këshillit arrihet me nëntë (9) anëtarë me të drejtë vote. Vendimet e Këshillit merrem me shumicë të thjeshtë të votave nga anëtarët e pranishëm, përveç nëse ligji e përcakton ndryshe.

Neni 9

1. Neni 13 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13
Buxheti Vjetor

1. Këshilli përgatit propozimin e buxhetit vjetor dhe ia dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe prokuroritë në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe auditimeve financiare.

Neni 10

Neni 14 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 14
Sekretariati i Këshillit

1. Sekretariati themelohet për të ndihmuar dhe zbatuar rregullat, rregulloret dhe politikat e Këshillit, lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e prokurorive.
2. Sekretariati zhvillon dhe propozon rregulla administrative që janë të nevojshme për zbatimin e urdhëresave të Këshillit. Të gjitha rregullat e tilla do t'i dërgohen Këshillit për miratim.
3. Sekretariati i propozon Këshillit politika të reja, rregulla dhe rregullore çdo herë që është e nevojshme për administrim efikas dhe efektiv të prokurorive.

4.Sekretariati i raporton rregullisht Këshillit për punën e prokurorive dhe ofron rekomandime për përmirësime.

5.Sipas udhëzimeve të Këshillit dhe Komisionit të tij për Buxhet, Financa dhe Personel, Sekretariati përgatitë një buxhet të konsoliduar për prokurorinë dhe administron buxhetin e miratuar të prokurorisë.

6.Sipas udhëzimeve të Këshillit dhe Komisionit të tij për Buxhet, Financa dhe Personel, Sekretariati menaxhon me personelin administrativ dhe mbështetës të prokurorive përfshirë këtu alokimin e personelit administrativ dhe mbështetës në prokurori bazuar në ngarkesën me punë, mirëmbajtjen e regjistrave të personelit, sistemin e vlerësimit të performancës, sigurimin e disiplinimit të duhur të punonjësve të prokurorive si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të punësimit.

7.Bazuar në kufizimet buxhetore dhe në udhëzimet e Këshillit, Sekretariati sigurohet që prokuroritë të kenë furnizim të duhur me materiale të nevojshme për funksionim efikas dhe efektiv të prokurorive.

8.Sekretariati ofron mbështetje administrative për Këshillin dhe komisionet e veta, si dhe ndërmerr detyra dhe autorizime të tjera sipas udhëzimeve të Këshillit.

9.Këshilli zhvillon dhe miraton rregullore që ndërlidhen me strukturën organizative dhe funksionimin e Sekretariatit.

Neni 11

Pas nenit 14 të ligjit bazik shtohen dy nene të reja 14/A dhe 14/B me tekstin si në vijim:

Neni 14/A Drejtori i Sekretariatit

1. Drejtori përzgjidhet, emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli në përputhje me procedurat, kriteret dhe kualifikimet që zhvillohen dhe miratohen nga ana e Këshillit përmes rregulloreve, të cilat janë në pajtim me detyrimet kushtetuese si dhe detyrimet nga rregulloret e zbatueshme të personelit.

2. Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrim efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe të prokurorive. Drejtori i raporton drejtpërsëdrejti Kryesuesit të Këshillit. Drejtori do të merr pjesë në të gjitha takimet e Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion.

3.Këshilli cakton pagën e Drejtorit të Sekretariatit.

Neni 14/B Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve

1.Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve përbëhet nga prokurorët me përvojë dhe me integritet të lartë profesional dhe personal

2. Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve udhëhiqet nga një anëtar i Këshillit nga radhët e prokurorëve.

3. Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve vlerëson performancën e prokurorëve në pajtim me nenin 21 të ligjit bazik dhe nenin 14 të këtij ligji. Vlerësimi i Komisionit është bazë për avancimin apo uljen në detyrë si dhe për shkarkimin nga detyra e prokurorit të shtetit.

4. Komisioni për punën e tij i përgjigjet Këshillit.

5. Përbërja, mandati, kriteret, mënyra dhe çështje tjera lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve rregullohet me këtë ligj dhe rregullore të miratuar në Këshill.

Neni 12

Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 3 fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 13

Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3, pas fjalës: “së Prokurorisë”, fshihen fjalët: „Drejtori nuk pranon kompensim shtesë për detyra apo punësim tjetër nga cilido burim tjetër përveç rimbursimit për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme”.

Neni 14

1. Neni 21 i ligjit bazik, pas paragrafit 3, shtohen paragrafët e ri 4, dhe 5 me tekstin si në vijim:

4. Vlerësimi i performancës së prokurorëve, me mandat fillestar, bëhet së paku dy herë gjatë këtij mandati nga Komisioni për vlerësim të performancës së prokurorëve, një herë pas trajnimit fillestar dhe një herë në fund të mandatit fillestar. Kriteret për vlerësim gjatë mandatit fillestar do të specifikohen në një rregullore të nxjerrë nga Këshilli.

5. Vlerësimi i performancës së prokurorëve me mandat të përhershëm bëhet çdo tre (3) vjet, në mënyrën e tillë që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli cakton me short një e treta (1/3) e prokurorëve, brenda secilës prokurori, si grupin e parë të cilët do t’u nënshtrohen vlerësimit të performancës në afat prej tre (3) muajsh. I njëjti short mbahet pas një (1) viti për të caktuar prokurorët që do bëjnë pjesë në grupin e dytë dhe grupin e tretë pas dy (2) viteve, respektivisht.

2. Neni 21 i ligjit bazik, paragrafi 3, pas fjalës “me shkrim”, shtohet fjala “në Këshill”, dhe vazhdon fjalia.

Neni 15

Neni 23 i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

Neni 23 Komisioni Disiplinor i Këshillit

Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë, njeri prej tyre është prokuror dhe anëtar i Këshillit, i cili është edhe kryesues i Komisionit, ndërsa një anëtar është prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe një anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit.

Neni 16

Neni 25 i ligjit bazik, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi ri 3 me tekstin si në vijim:

3. Procedura nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komision pasi që të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe dy (2) vite nga dita shkeljes së supozuar.

Neni 17

Neni 29 i ligjit bazik, pas paragrafit 4 shtohen paragrafët i ri 5, dhe 6 me tekstin si në vijim:

5. Këshilli gjatë vendosjes për ankesë mund të refuzojë ankesën, vërtetoj ose ndryshojë vendimin e Komisionit Disiplinor.
6. Në rastin kur Zyra e Prokurorit Disiplinor ka lejuar parashkrimin e lëndës, ose shtyrjen e dërgimit të saj në gjykim tek Komisioni Disiplinor, gjë që rezulton ta pamundësojë këtë të fundit për ta shqyrtuar atë sipas këtij ligji, Komisioni detyrohet ta njoftojë Këshillin për një lëshim të tillë të Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Mbi një lëshim të tillë, Këshilli kërkon përgjegjësi zyrtare nga Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe nëse për një gjë të tillë nuk merret përgjegje e arsyetuar, një lëndë të tillë detyrueshëm ia adreson Prokurorit të Shtetit për hetim eventual të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga Zyra e Prokurorit Disiplinor.

Neni 18

Neni 40 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas fjalës "të prokurorëve", fshihen fjalët "të kandidatëve për prokuror".

Neni 19

1. Nenet 3, 4, 8 dhe 10 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga data 1 Janar 2016.

2. Rregulloret e përcaktuara në këtë ligj do të nxirren në afat prej gjashte (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -035
28 maj 2015

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI